

**Plani i veprimit për realizimin e rekomandimeve nga Zyra Kombëtare e Auditimit për vitin 2019**

Menaxhmenti përmes Bordit të Drejtorëve do të ndjeke në menyrë të vazhdueshme zbatimin e rekomandimeve të përcaktuara sipas planit të veprimit në mënyrë që të mundësojnë zbatimin sipas afateve të përcaktuara .

Numri i Rekomandimit	Zyra Kombetare e Auditimit /Rekomandimi	Afati i perckatuar	Personi pergjegjes per realizimin e rekomandimeve
Rekomandimi A1-	Bordi i drejtorëve të sigurojë një rishikim gjithëpërfshirës të regjistrit të pasurisë dhe të ndërmarrë veprime konkrete për rivlerësimin dhe rishikimin e jetës së dobishme të pasurive së paku një herë në (5) pesë vite. Kjo me qëllim të paraqitjes së vlerës reale të pasurive, në përputhje me kërkesat e SNK 16.	Afati I zbatimit viti 2021	Menaxhmenti I Kompanise permes Bordit te Drejtorëve
Rekomandimi A2	Bordi i drejtorëve të sigurojë që janë marrë veprimet e duhura për të identifikuar konsumatorët, mjetet e të cilëve janë në llogarinë “Pagesa të pidentifikuara” dhe se u janë zbritur obligimet e papaguara ndaj kompanisë.	Afati I zbatimit viti 2020	Menaxhmenti I Kompanise permes Bordit te Drejtorëve

Rekomandimi A3	Bordi i drejtorëve të sigurojë që shënimet shpjeguese të përmbajnë parimet bazë që përdoren për hartimin e pasqyrave financiare, njohjen e të arkëtueshmeve dhe informacionet mbi përbërjen e zërave të pasqyrave janë dhënë sipas kërkesave të standardeve të kontabilitetit.	Afati I zbatimit viti 2020	Menaxhmenti I Kompanise permes Bordit te Drejtoreve
Rekomandimi A4	Bordi i drejtorëve të sigurojë hartimin dhe miratimin e udhëzuesit të politikave dhe procedurave kontabël dhe zbatimin e tij në mbajtjen e librave kontabël dhe raportim financiar.	Afati I zbatimit viti 2020	Menaxhmenti I Kompanise permes Bordit te Drejtoreve
Rekomandimi A5	Bordi i drejtorëve të sigurojë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar harmonizimet e shënimeve në mes të departamenteve dhe korrigjimet e gabimeve të identifikuar te saldo e llogarive të arkëtueshme dhe te pasqyra e rrjedhës së parasë së gatshme.	Afati I zbatimit viti 2020	Menaxhmenti I Kompanise permes Bordit te Drejtoreve
Rekomandimi A6	Bordi i drejtorëve të sigurojë se janë marrë veprimet e nevojshme korrigjuese për harmonizimin e të dhënave ndërmjet modulit të shitjes me modulën e kontabilitetit, në mënyrë që të sigurohet informacioni i saktë i vlerës së llogarive të arkëtueshme.	Afati I zbatimit viti 2020	Menaxhmenti I Kompanise permes Bordit te Drejtoreve
Rekomandimi A7-	Bordi i drejtorëve të sigurojë që të gjitha detyrimet ndaj operatorëve ekonomik paguhen brenda afateve kohore të akorduara në kushtet e kontratës në mes dy palëve.	Afati I zbatimit viti 2020	Menaxhmenti I Kompanise permes Bordit te Drejtoreve

Rekomandimi A8	Bordi i drejtorëve të siguroj që në çdo proces të rekrutimit, zbatohen në përpikëri procedurat përkatëse, në mënyrë që proceset e rekrutimit të jenë sa më transparente dhe në përputhje me kërkesat ligjore e rregullative.	Afati I zbatimit viti 2020	Menaxhmenti I Kompanise permes Bordit te Drejtoveve
Rekomandimi A9-	Bordi i drejtorëve të siguroj hartimin e një rregulloreje apo udhëzuesi për procedurën dhe mënyrën e ndarjeve të stimujve të performancës pozitive të punëtorëve. Stimujt të jepen vetëm në bazë të procedurës zyrtare të miratuar, e cila do të duhej të siguronte transparencë dhe trajtim të barabartë për të gjithë punonjësit e kompanisë	Afati I zbatimit viti 2020	Menaxhmenti I Kompanise permes Bordit te Drejtoveve
Rekomandimi A10	Bordi i drejtorëve të siguroj se të gjitha projektet e kontraktuara realizohen brenda afateve të parapara, të jenë të mbuluara me sigurim të ekzekutimit të kontratës deri në pranimin final të tyre, dhe në rast të skadimit të vlefshmërisë së sigurimit para përfundimit të projektit, të vazhdohet afati i vlefshmërisë së tij.	Afati I zbatimit viti 2020	Menaxhmenti I Kompanise permes Bordit te Drejtoveve
Rekomandimi A11	Bordi i drejtorëve të siguroj se ndryshimi i kushteve fillestare të kontratave bëhet përmes departamentit të prokurimit dhe se këto ndryshime reflektohen në kontratën bazë.	Afati I zbatimit viti 2020	Menaxhmenti I Kompanise permes Bordit te Drejtoveve

Kryesuesi i Bordit  
  
**Elhame Shefkiu**



Kryeshefi Ekzekutiv  
  
**Muhamed Suljqi**

**Data : 31.08.2020**